VENDIM
Nr. 640, datë 16.10.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 326, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS DHE PUNONJËSVE TË TJERË TË SPECIALITETEVE TË NDRYSHME NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) shkronja "e", e pikës 12, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"e) Punonjësve në pozicionin "shofer autoambulance" në institucionet shëndetësore të shërbimit spitalor dhe paraspitalor, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj.";

b) në numrin rendor 1, të kreut I/8, "Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të institucioneve qendrore", shtohet emërtesa "shofer autoambulance në institucionet shëndetësore në nivel qendror të shërbimit spitalor dhe paraspitalor, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe në Spitalin Universitar të Traumës";

c) në numrin rendor 2, të kreut II/1, "Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për çdo klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij vendimi, dhe të disa institucioneve të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes", shtohet emërtesa "shofer autoambulance në spitalet rajonale/bashkiake dhe qendrat shëndetësore të kujdesit parësor të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2024, përballohen nga buxheti i miratuar i ministrive përgjegjëse dhe nga fondet e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Mbrojtjes dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2024.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku